

**Shpallja e vendeve të lira të punës**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Specialist/ Administrator sistemi	QNOD	Durrës	Me afat të caktuar	Po		1.09.2016	15.09.2016

Formulari nr. 1

<b>1.Pozicioni i punës: Specialist / Administrator sistemi</b>
<b>2. Kodi i pozicionit: Sektori i IT dhe Operatorëve</b>
<b>3. Reparti/Institucioni: Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare</b>
<b>4. Vendi: Durrës</b>
<b>5. Paga: Kategoria IV -a</b>
<b>6. Lloji i kontratës së punës: Me afat të caktuar</b>
<b>7. Data e fillimit të aplikimit: 01.09.2016</b>
<b>8. Data e mbylljes së aplikimit: 15.09.2016</b>
<b>9. Mënyra e aplikimit:Me dosje</b>
<p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a>. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Njesisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën ( adresa postare e repartit/strukturës përkatëse): Psh.</p> <p><i>Drejtoria së Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse</i></p> <p><i>Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare</i></p> <p><i>Plepa - Durrës</i></p>
<b>10. Dokumentet e aplikimit:</b>
<p>Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ kërkesën;</li> <li>▪ formularin e aplikimit;</li> <li>▪ fotokopje të kartës së identitetit;</li> </ul>

- diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike eëë. mod.gov.al. (*linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

### 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

### 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: DND, Mastër i Shkencave
- b. Arsimi : Të jetë diplomuar në degët elektronikë ose informatikë
- c. Kualifikimi: në fushën e elektronikës dhe informatikës
- d. Trajnimi:

Eksperiencia në Punë: mbi 3(tre ) vjet në fushën e elektronikës ose informatikës.

- e. Gjuha e huaj: preferohet gjuha angleze
- f. Kërkesa të tjera specifike:
- g. Niveli i certifikatës së sigurisë: Niveli “B”, sekret.

### 13. Përshkrimi i punës: Specialist / administrator sistemi

- a. Detyrat kryesore:
  - Të njohë mirë topologjinë e rrjeteve, protokollat dhe mediumet e rrjetave.
  - Të mbikqyrë vazhdimisht funksionimin e sistemeve/rrjeteve, serverave, pajisjeve kompjuterike dhe burimeve të ushqimit.
  - Të monitorojë trafikun e rrjetit dhe të testojë atë për të meta.
  - Të administrojë pajisjet hyrëse/dalëse dhe aplikacionet.
  - Të bëjë kontrolle dhe inspektime të gjëndjes së aparaturave dhe sistemeve në funksion të QNOD-së në çdo kohë dhe në çdo vend ku ato ndodhen me qëllim që të sigurojë gatishmërinë

e sistemeve për punë të vazhdueshme 24-orë.

- Të mbikqyrë gjëndjen e monitorëve LCD në Sallën Operacionale.
- Të riparojë defektet e mundëshme për të siguruar punën e vazhdueshme të sistemeve.
- Të raportojë Përgjegjësit të Sektorit ITO, mbi gjëndjen e sistemit, defektet dhe masat e marra për riparimin e tyre.
- Të evidentojë në regjistër e shërbimet të sistemeve, defektet dhe masat e marra për eliminimin e tyre.
- Të bëjë azhurnimin e softeve dhe antivirusëve të instaluar në system.
- Të grumbullojë, përpunojë dhe menaxhojë çdo informacion të ardhur në forma dhe nga burime të ndryshme në QNOD.
- Të mbikqyrë administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së sistemeve në QNOD.
- Të administrojë dhe mirëmbaj kompjuterat dhe softwarët në QNOD.
- Të bëjë backup-et e sistemeve, arshivimin dhe rikuperimin e të dhënave në rast dëmtimi ose shkatërrimi.
- Të njohë mirë topologjinë e rrjetit të Radiokomunikimit “Tetra”, protokollet dhe mjediset e transmetimit.
- Të mbikqyrë vazhdimisht funksionimin e radiostacioneve dhe burimeve të ushqimit.
- Të mbikqyrë gjëndjen e sistemit të Dispatcherave.
- Të mbikqyrë administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së radiostacioneve.

b. Përgjegjësitë:

- Menaxhimin, administrimin dhe gjëndjen fiziko-teknike të dhomës së serverave të sistemeve të IT dhe komunikimit.
- Mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik (LAN) dhe pajisjeve kompjuterike.
- Menaxhimin, administrimin dhe monitorim i gjendjes së sistemit qëndror dhe stacioneve me anë të programit të monitorimit.
- Kryerjen e mirëmbajtjes periodike dhe backup të serverave dhe aparaturave qendrore.
- Të organizojnë dhe menaxhojnë në bashkëpunim me institucionet e interesuara programimin e radiove të Sistemit TETRA.
- Të përcaktojnë llojin e difekteve dhe të drejtojnë grupin e punës që do të shkojë në radiostacione për riparimin e difekteve.

#### 14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.  
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcaktonë kandidatët që

plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotëojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Intervista** zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerëson në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

